



Nr.06/13

Fletushkë informative mujore

Qershor, 2013



PËR HERË TË PARË, NË KOSOVË, FESTOHET 24 QERSHORI, "DITA E EGJIPTIANËVE TË BALLKANIT"



**Debati Parlamentar lidhur
me Strategjinë e
Qeverisë së Kosovës**

Dr. Rubin Zemon
Antropologjia
Socio-Kulturore e
Egjiptianëve në Ballkan

Botohet libri
"Antropologjia Socio-
Kulturore e Egjiptianëve
në Ballkan" e autorit
Dr. Rubin Zemon



**Nazmi Arifi, lideri i parë i
Egjiptianëve në Ballkan**



Egjiptianët e Ballkanit në proces të formësimit të identitetit të tyre etnik

Fazli Stollaj

Pozita aktuale e Egjiptianëve në Ballkan në masë të madhe pasqyrohet me faktin e zgjimit të vonshëm të ndërgjegjes kombëtare dhe si pasojë e kësaj, formësimi i identitetit etnik është në proces. Procesi i formësimit të identiteti vazhdon pa dallime të mëdha në të gjitha vendet e Ballkanit, diku më progres dhe diku me ngecje. Procesi i formësimit të identitetit etnik të Egjiptianët në Ballkan, në radhë të parë, varet prej shkallës së organizimit të kësaj bashkësie për përfaqësimin e interesave nacionale, nga zhvillimet e përgjithshme në rajon dhe përparimin e sistemit demokratik në këto vende. Sistemi demokratik i aplikueshëm në të gjitha shtetet e Ballkanit, edhe pse sistem i brishtë, garanton të drejtën e deklarimit të lirë të përkatësisë etnike dhe të prezantimit të vlerave të veçanta. Kjo është si rezultat i pretendimeve të këtyre vendeve për të aderuar në Bashkimin Evropian dhe si kushte i kanë të vendosura plotësimin e standardeve që burojnë nga konventat ndërkombëtare për respektimin e lirive dhe të drejtave të njeriut. Sot në asnjë vend të Ballkanit nuk është e ndaluar deklarimi i përkatësisë etnike por në masë të madhe ekziston një turrje nga vetë komuniteti si pasojë e zgjimit kombëtar të vonshëm e që ndërlidhet me sistemet jo demokratike të vendeve të Ballkanit. Me 24 Qershor 1990 kemi organizimin e parë publik në Oher kur u formua Shoqata e Egjiptianëve të Jugosllavisë. Tranzicioni dhe luftërat e përgjakshme që ndodhen në vendet e ish Jugosllavisë e komplikuan çështjen e avancimit politik juridik të Egjiptianëve në Ballkan. Gjatë viteve 90 në Kosovë ishte instaluar një sistem shtetëror represiv ku edhe komuniteti egjiptian kishte pasoja si në organizimin dhe në formësimin e identitetit etnik. Format e organizuara të Egjiptianëve në Kosovë gjatë viteve 90 u manipuluan nga pushteti i atëhershëm i instaluar në Kosovë dhe nuk e kishin lirinë e duhur të veprimit. Këto lëvizje gjatë viteve 90 arritën të mbajnë dhe të avancojnë procesin e identitetit por ky proces u dëmtua në masë të madhe pas vitit 1999 kur Kosova u administrua nga Kombet e Bashkuara për shkak se nga individ të caktuar duke e përdorur prezencën ndërkombëtare dhe duke i kualifikuar lëvizjet e Egjiptianëve në Kosovë si bashkëpunëtor të pushtetit represiv, ata arritën që të dëmtojnë identitetin duke e deklaruar me etnonimn lokal ashkali. Tani komuniteti Egjiptian në Kosovë është me dy identitete: egjiptian dhe ashkali. Të dy këto identitete janë të formalizuara me kushtetutë dhe ligje dhe kjo bëri që dyshimet nga të tjerët

për identitet të veçantë nga romët të rriten në masë të madhe. Identitetin etnik të Egjiptianëve në Kosovë, në masë të madhe e ka dëmtuar edhe faktori ndërkombëtar përmes përdorimit racist të shkurtesave RAE e që vazhdon edhe sot të përdoret nga OJQ dhe mediat në Kosovë. Termi RAE kishte depërtuar edhe në Mal të Zi nga UNHCR për refugjatet nga Kosova. Cenimin e identitetit etnik në Kosovë e bëri edhe Qeveria e Kosovës përmes një dokumenti strategjik për integrimin e komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptian. Ky dokument i servuar nga Organizata të sponsorizuara nga Bashkimi Evropian nuk bënte kurrfarë dallime në mes të romëve dhe komunitetit Egjiptian/ Ashkali.

Procesi i formësimit të identitetit etnik në Kosovë ka shënuar progres për shkak të organizimit të subjektit politik i cili u përfaqësua në Kuvendin e Kosovës dhe në Komunitatet e Kosovës. Pjesëmarrja në zgjedhje të organizuara në Kosovë, prezantimi i programeve për çështje të Egjiptianëve, pjesëmarrja e shoqërisë civile në programe të caktuara bëri që të avancohet çështja e formësimit të identitetit etnik.

Procesi i integritetit të vendeve Ballkanike në Institucionet Evropiane dhe shfrytëzimi i mekanizmave të sistemit demokratik janë prespektiva e formësimit të identitetit të veçantë etnik. Arritja e pajtueshmërisë për një emërtim të përshtatshëm për të gjithë egjiptianët e Ballkanit që të dallohen nga shtetasit e Egjiptit do të ndikojë në njerëzit tanë të mos hezitojnë të identifikohen. Nuk ka dyshim se ndërgjegjja për veçanti etnike është e sforcuar, por etnonimet e shumta të përdorura shpesh, edhe me karakter përbuzës, e dëmtojnë identitetin dhe bëjnë që një numër të vogël i njerëzve të hezitojnë të quajnë veten egjiptian. Shumë më lehtë deklarohen përmes etnonimeve si magjup ose ashkali sesa si egjiptian. Publikimi i fakteve shkencore e forcon identitetin e egjiptianëve. Zhvillimi i aktiviteteve kulturore për komunitetin egjiptian, ngritja e personaliteteve në letërsi, këngë, ndarja e çmimeve në emër të personaliteteve, prania në media e forcon ndërgjegjen kombëtare të Egjiptianëve në Ballkan. Festimi i 24 Qershorit si Dita e Egjiptianëve në Ballkan është një e arritur e mirë në avancimin e procesit të formësimit të identitetit etnik. Përzgjedhja e një flamuri të përbashkët për të gjithë egjiptianët e Ballkanit do të rritë ndërgjegjen kombëtare dhe e përforcon identitetin tonë etnik.



Me 24 Qershor në “Ditën e Egjiptianëve të Ballkanit”, në Prishtinë, u promovua libri “Antropologjia Socio-Kulturore e Egjiptianëve në Ballkan”

Me 24 Qershor, në ditën kombëtare të Egjiptianëve të Ballkanit, në Prishtinë në ambientet e Bibliotekës Universitare të Kosovës, u promovua libri me titull "Antropologjia Socio-Kulturore e Egjiptianëve të Ballkanit" e autorit Dr. Rubin Zemon. Në praninë e rreth 100 pjesëmarrësve redaktori i librit Esat Loshaj nga Shoqata e Shkrimtarëve të Pejës bëri një interpretim të përmbajtës së librit duke e cilësuar këtë libër risi shkencore lidhur me një komunitet i cili është i pranishëm në trevat e Ballkanit. Redaktori i librit që e prezantonte botuesin e librit potencoj rëndësinë e botimit të librit me faktin se kjo është një pasuri për shkencën në përgjithësi. Etnologu Dr. Bashkim Lajçi bëri një interpretim të librit duke i përmendur pjesët e caktuara nga libri dhe duke i komentuar ato. Interpretimin e librit e ka bërë përmes video linkut edhe Prof. Dr. Armanda Kodra Hysa ligjëruese në Londër. Ajo e cilësoi këtë libër si bazament shkencor mbi Egjiptianët e Ballkanit. Ajo theksoi se autori i librit i ka përdorur edhe historinë edhe etnologjinë edhe arkeologjinë dhe një literaturë të gjerë përmes të cilës në mënyrë të shumë të qartë e ka argumentuar prezencën e Egjiptianëve në Ballkan në të gjitha periudhat. Në këtë promovim kanë fol edhe deputetet e Parlamentit të Kosovës z. Xhevdet Neziraj dhe z. Gëzim Kelmendi, zëvendës ministri i Kulturës

Rinisë dhe Sporteve z. Gani Elshani, dhe ish deputeti i Parlamentit të Kosovës z. Bislim Hoti. Autori i librit Dr. Rubin Zemon u shpreh i emocionuar për botimin e librit dhe shprehu kënaqësinë e veçantë që ky libër u botua për herë të parë në gjuhën shqipe dhe në Kosovë ku komuniteti Egjiptian është i njohur edhe me Kushtetutë të vendit. Ky libër që në fakt ishte punim doktore i mbrojtur pranë Akademisë së Shkencave të Bullgarisë në vitin 2005 është hulumtimi i parë shkencor lidhur me Egjiptianët e Ballkanit dhe është nder për mua që po promovohet me 24 Qershor në Ditën e Egjiptianëve të Ballkanit ku sot po mbushën 23 vite nga dita e mbajtjes së Kuvendit të Parë të Egjiptianëve në Ohër të Maqedonisë. Në këtë promovim përpos pjesëmarrësve nga rajonet e ndryshme të Kosovës dhe të Maqedonisë kanë marrë pjesë edhe përfaqësuesit e Zyrës së Kryeministrit për çështje të komunitete, përfaqësuesit të Sekretariatit të Këshillit Konsultativ për Komunitete, përfaqësues nga OSCE dhe përfaqësues nga Ambasada e Zvicrës. Në fund të promovimit, autori i librit shpërndau libra për të pranishmit. Botimi i librit është mbështetur financiarisht nga Zyra e Kryeministrit për çështje të komuniteteve.



Me ekspozitë të fotografive, në Istog, filluan manifestimet e 24 Qershorit, Ditës së Egjiptianëve të Ballkanit

Me datën 21 Qershor 2013 në Istog u hap ekspozita e fotografive e emëruar "Rrugëtimi i Egjiptianëve të Ballkanit". Janë përzgjedhur 30 fotografi përmes të cilave është treguar lashtësia e Egjiptianëve në Ballkan, mënyra e veshjes dhe zanatit të ushtruar, personalitetet që kanë lenë gjurmë në muzikë dhe ngjarje të rëndësishme. Në hapje të ekspozitës përpos një numri të konsiderueshëm të pjesëtareve të komunitetit egjiptian nga komuna e Istogut ka marrë pjesë edhe kryetari i IRDK-së z.Xhevdet Neziraj, kryetari i komunës së Istogut z.Haki Rugova, kryesuesi i Kuvendit z.Demë Çeta, përfaqësues nga UNMIK dhe KAD dhe përfaqësues tjerë. Hapjen e kësaj ekspozite e bëri zëvendës kryesuesi i Kuvendit komunal të Istogut z.Fazli Stollaj i cili nder të tjera theksoj se është kënaqësi e veçantë që manifestimi për 24 Qershorin fillojnë në Istog ku komuniteti Egjiptian në këtë komunë është pjesë e rëndësishme. Ai theksoi se kjo është hera e parë që po festohet 24 Qershori dhe shpjegoj rëndësinë e Kuvendit të Ohrit 1990. Ai tha se në këtë ditë duhet t'i kujtojmë institucioneve të vendit se komuniteti Egjiptian nuk është në pozitë të mirë në shoqëri dhe duhet bërë shumë më shumë që të luftohen paragjykimet që ekzistojnë për këtë komunitet.

Kryetari i komunës së Istogut z.Haki Rugova uroj 24 Qershorin dhe theksoj se në komunën e Istogut kemi qenë të kujdesshëm që të financojmë projekte dhe gjithmonë i kemi pritur mirë kërkesat e

tyre. Ai tha se edhe ju duhet të organizoheni më mirë në mënyrë që kërkesat e juaja të adresohen si duhet. Në veçanti bëri apel që komuniteti egjiptian të shkollohet më shumë.

Kryetari i IRDK-së z.Xhevdet Neziraj iu uroj të gjithëve 24 Qershorin dhe nder të tjera theksoj se përmes kësaj ekspozite të fotografive janë tregua vlerat dhe traditat e komunitetit tonë që gjithmonë kanë qenë sikur të shqiptarëve dhe është mirë që të tregojmë se atyre që na futen në komunitete fantome RAE se ne kemi identitet të veçantë. Ai theksoi se gjenerata të tera kanë jetuar me vendasit dhe prejardhja jonë etnike nga Egjipti është një vlerë për gjithë rajonin.

Pas hapjes së ekspozitës për të pranishmit pati një kotkej rasti. Ekspozita është financuar nga komuna e Istogut.





Në Fushë Kosovë, është festuar 24 Qershori "Dita e Egjiptianëve të Ballkanit", përmes organizimit të ceremonisë së ndarjes së çmimeve nga turniri në futboll dhe në shah. Nënkryetari i IRDK-së z.Ramadan Hasani në këtë tubim ju drejtua të pranishmëve për rëndësinë e 24 Qershorit, për respektin që duhet treguar për gjeneratat që dhanë mund për çështjen e popullit tonë dhe për mundësitë e përmirësimit të pozitës së komunitetit Egjiptian. Ai iu kujtoj të pranishmëve Kuvendin e Ohrit 1990 ku ishte themeluar shoqata e parë e Egjiptianëve dhe sakrificën e gjeneratave të për identitet të veçantë. Kryetari i degës së IRDK-së në Fushë Kosovë

z.Bedri Mustafa i cili është njëherësh edhe zëvendës kryesues i KK në Fushë Kosovë i uroj të pranishmit 24 Qershorin dhe nder të tjera theksoi se kjo datë është historike sepse edhe komuniteti egjiptian e ka ditën e tyre. Të pranishmëve në këtë ceremoni iu drejtuan edhe z.Fazli Stollaj, z.Imer Alijaj, z.Elbert Krasniqi dhe Dr.Skender Marolli të cilët shfaqen admirim për 24 Qershorin dhe uruan Fushë Kosovën për këtë Ditë të Madhe. Në fund fituesve të turnirit në futboll dhe shah iu shpërndanë trofetë. Solemniteti përfundoj me një koktej për të pranishmit.





Tryezë Diskutimi “ Pozita Juridike dhe Politike e Egjiptianëve në Ballkan”

Në Pejë, nën organizimin e Kryesisë së IRDK-së, në prag të 24 Qershorit është mbajtur tryezë diskutimi me temën “Pozita Juridike dhe Politike e Egjiptianëve në Ballkan”. Në këtë tryezë diskutimi kanë marrë pjesë student, intelektual dhe përfaqësues nga Peja Istogu, Fushë Kosova dhe Struga. Nga panelistet e planifikuar që të referojnë kanë marrë pjesë Xhevdet Neziraj dhe Fazli Stollaj, ndërsa nuk ka marrë pjesë Rubin Zemon por është drejtuar të pranishmeve përmes skype, Beslim Hoti dhe Behar Sadiku. E veçantë e tryezës ishte pjesëmarrje e katër pjesëtareve të Egjiptianëve nga Struga e Maqedonisë të cilët pa e njohur asnjërin nga organizatorët kishin pranuar të marrin pjesë në këtë diskutim. Xhevdet Neziraj në referimin e tij ka paraqitur pozitën e Egjiptianëve të Kosovës duke e saktësuar pozitën juridike dhe faktike të komunitetit. Ai potencoj faktin e njohjes së Egjiptianëve me kushtetutë dhe ligje paraqiti format dhe arsyet e organizimit të Egjiptianëve dhe gjendjen e tanishme e cila siç theksoi ai nuk është ashtu siç dëshirojmë të jetë. Fazli Stollaj diskutimin e tij e përqendroi në identitetin etnik të egjiptianëve në Ballkan si proces i cili vazhdon. Ai theksoi se ne jemi ende në formësim të identitetit etnik për shkak se kemi dalë publikisht vonë me identitetin egjiptian. Ai përmendi në mënyrë kronologjike format e organizuara të egjiptianëve në Ballkan, fazat nëpër të cilat kanë kaluar dhe gjendjen aktuale në të cilën ndodhen.

Pjesëmarrësit nga Struga paraqiten gjendjen e Egjiptianëve në Maqedoni të cilët ndër të tjera theksuan se në Maqedoni ka filluar deklarimi publik i egjiptianëve ndërsa tani nuk është gjendja aspak e mirë e këtij komuniteti atje. Ata në veçanti potencuan faktin e depërtimit të strukturave romë dhe kushtëzimet e pa moralshme që ju bëhen përmes fondeve. Në këtë diskutim që morën pjesë edhe të pranishëm të tjerë ndër të cilët Dr. Skender Marolli, Imer Alijaj, Muharrem Asllani, Adem Abazaj, Veton Berisha dhe të gjithë pjesëmarrësit nga Struga. Nga ky diskutim u konkludua nevoja e koordinimit të Egjiptianëve në Ballkan, shfrytëzimi i mekanizmave të sistemit për përmirësimin e pozitës në shoqëri, krijimin e strukturave të qëndrueshme të organizimit,





Kryesia e IRDK-së zgjedh Përgjegjësin Financiar

Me 19.05.2013 në Pejë është mbajtur mbledhja e rregullt e Kryesisë së IRDK-së. Në këtë mbledhje është diskutuar lidhur me punën dhe shpenzimet e IRDK-së për tremujorin e këtij viti nga ana e Kryesisë së IRDK-së dhe nga ana e degëve të IRDK-së, plotësimin e pozitave brenda Kryesisë, agjenda lidhur me manifestimet për 24 qershor dhe mundësia e prezantimit të egjiptianëve me një parti të vetme.

Kryetari i IRDK-së Xhevdet Neziraj në mënyrë të hollësishme ka raportuar lidhur me shpenzimet e IRDK-së për tremujorin e parë të këtij viti. Shifrat e prezantuar të shpenzimit janë të përafërta me planifikimin e buxhetit duke i veçuar shpenzimet për degë, shpenzimet operacionale dhe shpenzimet e qirasë. Edhe kryetarët e degëve të IRDK-së kanë dhënë shpjegimet e tyre lidhur me angazhimin e tyre për këta tre muaj dhe kanë arsyetuar shpenzimin e dedikuar për degë. Kryesia ka miratuar raportin tremujor të punës dhe financiar për Kryesinë dhe për degët e IRDK-së. Nga ana e anëtarëve të Kryesisë është vlerësuar e nevojshme plotësimi i pozitës së Përgjegjësit

Financiar dhe të kryetares së Forumit të Gruas së IRDK-së që të dyja pozita të parapara me statutin e IRDK-së. Pas një debati të anëtarëve të Kryesisë, Përgjegjësi Financiar i IRDK-së është zgjedhur Elbert Krasniqi ndërsa është vendosur që të kontaktohet znj. Kumrije Bajrami dhe të kërkohej nga ajo që të funksionalizoj Forumin e Gruas së IRDK-së. Në prag të 24 Qershorit është diskutuar lidhur me agjendën e manifestimit. Nga kryetari i Këshillit Organizativ për festimin e 24 Qershorit është paraqitur një draft agjendë e cila do të diskutohet me Këshillin Organizativ dhe pas konsultimeve të nevojshme me akteret e këtij organizimi do të bëhet publike agjenda. Në mbledhjen e Kryesisë së IRDK-së është konstatuar se komuniteti Egjiptian i nevojitet vetëm një parti politike e cila ka struktura demokratike dhe i jep mundësi të gjithëve që dëshirojnë që të kyqen dhe të jepen kontributin e tyre. Për këtë arsye shumë shpejt do të takohet kryetari i IRDK-së Xhevdet Neziraj me kryetarin e LEK-ut Beslim Hoti ku edhe do të vendosin në mënyrë të përgjegjshme për këtë çështje.



Kryesia e IRDK-së mbajti takim në degën e IRDK-së të Fushë Kosovës

Me datën 04.05.2013, Kryesia e IRDK-së ka zhvilluar takimin e saj në degën e Fushë Kosovës. Ky takim i kryesuar nga kryetari i IRDK-së Xhevdet Neziraj është zhvilluar në kuadër të planifikimit të mbajtjes së takimeve nëpër degë të IRDK-së në mënyrë që drejtpërdrejt anëtarët e Kryesisë të njoftohen me zhvillimet nëpër degë. Kryetari Xhevdet Neziraj, në fillim të takimit, ka bërë një prezantim të shkurtër të zhvillimeve kryesore gjatë këtij viti brenda IRDK-së dhe ka theksuar se aktivitetet në IRDK janë duke u zhvilluar sipas planit të veprimit të miratuar nga ana e Kryesisë së IRDK-së. Ai ka veçuar takimet që zhvillohen me popullatën dhe ka theksuar nevojën e vlerësimit të nevojave dhe halleve që paraqesin ata. Gjithashtu ai theksoi përpjekjet e IRDK-së për të bërë afrimin e

komunitetit tonë të ndarë dhe ka përmendur takimet që janë zhvilluar me partitë e komunitetit ashkali. Në këtë takim një prezantim të punës së tyre e kanë bërë anëtarët e Kryesisë të cilët përfaqësojnë komunën e Pejës, Istogut, Klinës. Të pranishmit në takim kanë pasur mundësi të shprehin opinionet e tyre lidhur me pozitën e komunitetit tonë, përparësitë dhe mangësitë e përfaqësuesve institucional dhe nevojën e mobilizimit për të qenë më të fuqishëm në përfaqësim. Është vlerësuar në veçanti nevoja e vazhdimit të përpjekjeve për përafrimin e Egjiptianëve dhe ashkalive dhe përforcimi dhe zgjerimi i strukturave të IRDK-së.



Debati Parlamentar lidhur me Strategjinë e Qeverisë së Kosovës për Integrimin e Komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptian 2009 - 2015

Me kërkesë të deputetit të IRDK-së Xhevdet Neziraj, i mbështetur edhe nga deputetët nënshkrues, me datën 06.06.2013 është mbajtur debat Parlamentar lidhur me strategjinë e Qeverisë së Kosovës për integrimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Republikën e Kosovës, 2009-2015.

I nderuar zoti nënkryetar i Kuvendit, Kolegë deputetë, Shumë të respektuar ministra, zëvendëskryeministra në Kabinetin qeveritar, dhe unë nuk di kujt do t'i drejtohem për këtë strategji, për arsye se strategjinë duhet ta zbatojë Qeveria, strategjinë e ka miratuar Qeveria. Bashkimi Evropian ia ka shitur Qeverisë dhe Qeveria duhet ta zbatojë. E Qeveria nuk është këtu për t'i dëgjuar hallet dhe problemet e komunitetit egjiptian dhe të komuniteteve tjera. Ajo është e interesuar të bëjë pazare tjera, të bëjë koncesione tjera dhe këtu është rëndësia dhe pesha për komunitetet tjera, që e kanë dhënë një kontribut për çështjen e pavarësisë së Kosovës, që kanë dhënë, janë duke dhënë dhe do ta japin një kontribut për çështjen e Kosovës, sepse

për mua Kosova është atdheu im etnik dhe duhet të kontribuoj për këtë vend. Komuniteti egjiptian është pjesë e rëndësishme e shoqërisë kosovare dhe është i pranuar edhe në Kushtetutën e Kosovës, por edhe me Ligjin për mbrojtjen dhe të drejtat e komuniteteve, pika 1, pika 1.4, ku në mënyrë decitive shkruan se komunitetet minoritare, që jetojnë dhe veprojnë në Kosovë, janë serbët, turqit, romët, ashkalinjtë, boshnjakët dhe egjiptianët, dhe nuk ka nevojë që të thuhet në forma tjera, sikur po e thonë edhe mediat, sikur po e flasin edhe shumë ministra, komuniteti RAE. Komunitet RAE nuk ka, se me ato shkurtesa nuk po dihet nëse është agjenci evropiane e rindërtimit, ndonjë OJQ, apo ndonjë organizatë tjetër. Dhe, prandaj, ky është një cenim i rëndë i identitetit të komuniteteve. Strategjia për integrimin e komunitetit rom, egjiptian dhe ashkali, e përpiluar nga Këshilli i Evropës, KFOS-i, është adaptuar nga Qeveria e Kosovës, do të thotë nuk është produkt i Qeverisë së Kosovës, por është marrë nga ajo dhe është strategji e komunitetit rom në Evropën Juglindore dhe vetëm është përkthyer

në gjuhën shqipe, dhe janë shtuar edhe dy komunitete tjera, e është sjellë këtu dhe për këtë arsye komuniteti egjiptian qysh në fillim e ka kritikuar dhe nuk ka qenë pjesë e kësaj strategjie dhe komentet që i kam dhënë qysh në vitin 2009, janë tani ato komente, nga të cilat nuk është implementuar asnjë pikë e asaj strategjie. Në atë strategji thuhet se komunitetet duhet të fuqizohen në sektorin e ekonomisë. Dhe, tash po i nxjerr disa argumente. Në ndërmarrjet publike në PTK, në KEK dhe në disa ndërmarrje tjera nuk është asnjë i punësuar. Dhe, a thua është ky fuqizim? Thuhet që Ministria e Planifikimit Hapësinor duhet të bëjë dhe ka strategji për rregullimin e vendbanimeve joformale. Dhe, e kam cekur edhe para kësaj seance, ministri Dardan Gashi e ka zgjedhur problemin e arushave, sepse ka ndarë 15 hektarë tokë, meqë kanë jetuar në mënyrë jokomode, ndërsa komuniteteve pakicë nuk ka gjetur kohë t'ua zgjidhë këtë problem. Një problem tjetër që thuhet strategjinë duhet ta implementojë Ministria për Komunitete dhe Kthim, kjo ministri që nga themelimi është njëra prej ministrie më kaotike në Qeverinë e Kosovës dhe është e njohur për keqmenaxhim, për keqpërdorim, ku krejt ministrat janë nëpër gjykata. Bile, disa edhe janë të dënuar me burg. Dhe, çka mund të pres unë prej atyre ministrave? Kjo ministri, që duhet ta implementojë këtë strategji, i ka 50 serbë të punësuar, i ka 50 shqiptarë të punësuar, do të thotë, siç thashë dje, ministri e vëllazërim-bashkimit, ndërsa nuk është asnjë pjesëtar i komunitetit egjiptian i punësuar, ose i komunitetit rom, apo edhe ashkali. Dhe, atëherë pse ekziston kjo ministri? Kjo ministri vetëm rastësisht e ka emrin e komuniteteve, se ajo merret me biznes, ajo merret me ndërtim, ajo merret me shoqata joqeveritare, ajo i shpërndan grante kujt të dojë, i shpërndan traktorë kujt të dojë, e as që merret me komunitete. Ky është realiteti dhe kjo është puna e ministrisë, që është duke bërë që nga viti 2004. Në strategji thuhet dhe e kam ditur që nuk do ta realizojnë, që Ministria e Ekonomisë duhet të ndajë fonde. Ministria e Ekonomisë, jo që nuk ka ndarë fonde, por as që është e pranishme, as që merret me këtë punë. Definitivisht, nuk po kërkoj fond, siç kanë kërkuar serbët dhe siç kanë kërkuar në bisedime, por kërkoj që në ato vendbanime ku jetojnë pjesëtarët e komuniteteve, atyre mund t'u ndihmohet në infrastrukturë, se nuk kërcet kiameti. Duhet t'u ndihmohet në ndërtim dhe rindërtim. Mund të punësohen njerëzit, një ose dy persona edhe në PTK, edhe në KEK, aq më tepër kur ka njerëz shumë-shumë të specializuar, edhe

me fakultete të kryera, aty ku i kanë kryer edhe kolegët shqiptarë. Atëherë, pse të mos jenë edhe ata pjesë e kësaj shoqërie? A duhet që gjithmonë disa komunitete të vuajnë për shkak të perceptimeve, për shkak të mosqasjes dhe shumë gjërave tjera? Unë po e shoh që Qeveria nuk ka qenë fare e interesuar dhe dua t'i shtjelloj rekomandimet. Rekomandimi i parë është që komuniteti egjiptian të hiqet nga kjo strategji, për arsye se kjo strategji, po të analizohet mirë, është që secili rom është edhe egjiptian, edhe ashkali. Secili ashkali është edhe rom, edhe egjiptian, dhe secili egjiptian është edhe rom, edhe ashkali, gjë që është antikushtetuese, që është antiligjore dhe që nuk ka të bëjë asgjë me të vërtetën. Veç e kanë futur një konfuzion edhe te populli i Kosovës, se nuk di kush kë e prezanton dhe ku kë e përfaqëson dhe kush është ai pjesëtar i atij komuniteti. Unë dua t'i përmendi veç edhe disa argumente. Janë mediat e Kosovës, gazetat që janë shumë profesionale, mediat elektronike, shkruajnë: Nxënësit RAE të komunitetit. Kush janë ata nxënës? A janë romë? A janë egjiptianë? A janë shqiptarë, a kush janë ata? A kanë emra dhe mbiemra? Ose, thuhet: Një pjesëtar i komunitetit, me emër dhe mbiemër, i komunitetit RAE. Po, a është pjesëtar i komunitetit egjiptian, a është rom, a është ashkali, i cilit komunitet? Do të thotë, këto media ose nuk e dinë Kushtetutën e Kosovës, ose janë të paguara që të shkruajnë kështu. Gjithashtu, mediat publike, sidomos Radiotelevizioni i Kosovës - Radiotelevizioni i Kosovës mund t'u them lirisht, jo vetëm që është publik, por mund t'ia vë edhe një emër - është radiotelevizion publiko-privat. Ai ka filluar t'i thërrasë shokët e vet, gazetarë, gratë e veta, shoqet e veta, t'ua rritin imazhin, të bëjnë debate me ta, ndërsa unë si deputet i Parlamentit të Kosovës në të gjitha legjislacionet, si anëtar i Komisionit Kushtetues, si anëtar që e ka nënshkruar pavarësinë e Kosovës, vetëm për debatet që i bëj këtu nuk më transmetojnë. Ndoshta munden edhe ta ndalin, ose nuk kanë interes të më ftojnë për një pikë të veçantë për problemet e komunitetit. Ndërsa dua ta përmend edhe me emër e mbiemër, zoti Buzhala ende nuk e ka përgatitur debatin që do ta bëjë, por veç është ftuar në RTK, është ftuar në KTV, është ftuar në KLAN. Do të thotë, qysh para se të dalë të bëjë debat, stema e tij është bërë aktuale. Ndërsa, tema ime rri plot katër javë në sirtarët e Kryesisë së Kuvendit, e ka Qeveria, e nuk vjen asnjë ministër, nuk vjen asnjë zyrtar tjetër. Prandaj, është një problemi se kjo Qeveri nuk është shumë e interesuar për zgjidhjen e problemeve. Në opinion është mirë të jesh minoritar, se ke privilegje. Unë nuk di se çfarë privilegjesh ka komuniteti egjiptian.

Është mirë të ma thotë dikush se i këto privilegje. Më nuk e ka asnjë privilegj, përveç këtij vendi të rezervuar që është këtu, edhe atë jam nënshkrues i pari, le të hiqet për krejt komunitetet, le të hiqet edhe për mua.

Unë jam i pari që do ta nënshkruaj, nëse hiqet për të gjitha komunitetet, do ta nënshkruaj edhe unë që të hiqet edhe për komunitetin tim. Dhe, mund të gjej vend pune, nëse jam një ekonomist, e kam kryer Fakultetin Ekonomik në Prishtinë, në një kohë shumë të vështirë, mund ta gjej edhe unë një bord të PTK-së, ose në bord të Trustit Pensional, ku janë rrogat më të mira se të deputetëve. Edhe ajo më takon. Mund ta kryej atë punë, se nuk janë më të mençur se unë, se e kemi kryer të njëjtën shkollë, na kanë ligjëruar të njëjtit profesorë. Kështu që mund ta kryej atë punë edhe më mirë, edhe më qetë. Një problem tjetër që dua ta theksoj është që kjo strategji, edhe nga Këshilli i Evropës ka dalë një deklaratë që të gjitha këto komunitete i quan "bredhës". Unë dua t'i them Këshillit të Evropës, që komuniteti egjiptian është tradicionalisht në Kosovë, asnjëherë nuk ka qenë endacak, asnjëherë nuk ka banuar me çadra, siç e quan ajo. Por, gjithmonë ka qenë vendës në këto troje, gjithmonë e ka folur këtë gjuhë që unë sot jam duke u drejtuar dhe gjithmonë ka pasur tradita dhe zakone shqiptare. Atë... (Ndërprerje nga regjia) KRYETARI: Regjia, edhe dy minuta! XHEVDET NEZIRI: Faleminderit! Atëherë nuk ka nevojë që Këshilli i Evropës të na e tregojë identitetin dhe kjo strategji e di që është e njerëzve nomadë, që i kanë nëpër Sllovaki, që i kanë nëpër Çeki, se qysh i trajtojnë ata e dinë - është problem i tyre. Ndërsa, problemi i komunitetit egjiptian nuk mund të zgjidhet në këtë formë. Unë jam i vetëdijshëm se institucionet tona janë duke u ballafaquar me shtet ndërtimin. Unë jam i vetëdijshëm se papunësia është shumë e lartë edhe për komunitetin shumicë, por është shumë e paqartë që të mos bëhet asnjë hap në këtë drejtim, me të cilin mund të zbutet papunësia te ky komunitet. Nuk mund të zbutet edhe papunësia, e nuk mund të ketë as arsim cilësor, nuk mund të ketë asgjë pozitive, nëse nuk ka fuqizim ekonomik. Edhe një problem tjetër, para dy vjetësh edhe vitin e kaluar është mbajtur festivali i kulturës rome, egjiptiane dhe ashkalike, të cilin e kanë financuar KFOS-i, SOROS-i, Shoqëria Civile, e të cilët nuk dinë as me çka merren, vetëm e kanë qëllimin e përfitimeve të tyre personale. E kanë organizuar një koncert, në të cilin e kanë sjellë një këngëtare shumë të njohur të komunitetit rom dhe thuhet se është kulturë egjiptiane. Ajo nuk ka të bëjë asgjë me kulturën egjiptiane. Se, ajo ka kënduar në gjuhën rome dhe

unë e përgëzoj. Unë ndoshta do ta kisha ftuar Bujar Qamilin të këndojë shqip, se më pëlqen. Këndon në atë gjuhën që unë e kuptoj. Dhe, ajo është pjesë e kulturës, e jo pjesë e kulturave të mia, që ta adaptoj një kulturë tjetër. Prandaj, kërkoj nga kolegët deputetë që t'i votojnë rekomandimet, sidomos rekomandimin e parë, që nga strategjia të hiqet komuniteti egjiptian dhe të vazhdojë për këto komunitete tjera. Unë do të gjej forma dhe metoda tjera demokratike që të sensibilizohet puna e komunitetit egjiptian në Kosovë. Faleminderit!

Si rezultat i këtij debati të iniciuar nga kryetari i IRDK, komuniteti Egjiptian nuk është pjesë e dokumentit të njohur si Strategjia e Qeverisë së Kosovës për Integrimin e komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptian.

Në këtë seancë Parlamentare janë votuar rekomandimet vijuese.

1. Problemet dhe nevojat e Komunitetit Egjiptian të Kosovës të mos adresohen përmes dokumentit "Strategjia për Integrimin e Komuniteteve Rom, Ashkali, Egjiptian në Republikën e Kosovës 2009-2015", dhe të ndryshohet emërtimi dhe përmbajtja e dokumentit duke mos e përmendur asnjëherë komunitetin egjiptian.


2. Qeveria e Republikës së Kosovës të ndërmerr masa për ngritjen e nivelit të arsimimit në të gjitha nivelet e arsimimit përmes hartimit të programeve të veçanta të subvencionimit të nxënësve dhe studenteve dhe për punësimin e të kualifikuarve.

3. Qeveria e Republikës së Kosovës të planifikoj një shumë të caktuar nga buxheti i Kosovës, për çdo vit, për financimin e projekteve të infrastrukturës në vendbanimet ku është i përqendruar komuniteti egjiptian.

4. Qeveria e Republikës së Kosovës të ndërmerr masa në zbatimin e ligjit të Shërbimit Civil dhe udhëzimeve administrative që burojnë nga ky ligj, e që kanë të bëjnë me përfaqësimin e komuniteteve në nivel lokal dhe qendror

5. Qeveria e Republikës së Kosovës të ndërmerr masa të veçanta, ashtu siç parashihet edhe në Ligjin për Mbrojtjen dhe Promovimin e të drejtave të komuniteteve, për punësim në Policinë e Kosovës, Doganat e Kosovës, FSK dhe Ndërmarrjet publike

6. Të sigurohet qasje e barabartë me komunitetet tjera në mediumet publike të Kosovës



Nazmi Arifi, lideri i parë i Egjiptianëve në Ballkan

Ndjenja e veçantisë etnike, e fshehur në ndërgjegjen tonë, u përcjell nëpër gjenerata dhe ishte e nevojshme që të manifestohej publikisht sepse këtë e kërkonte nevoja e të jetuarit me dinjitet. Popuj dhe grupe të caktuara janë identifikuar në bazë të personaliteteve të njohura të cilët kanë lenë gjurmë me veprat e tyre gjatë periudhës së të jetuarit. Intelektualet të cilët arritën të akumulojnë dituri gjatë shkollimit dhe karrierës së tyre, e që bënë mund të madh për të gënijer veten e tyre për identifikim me një grup etnik që realisht nuk i takojnë, nuk arritën të fitojnë epitetin e personalitetit.

Ata të cilët nuk e peshuan karrierën dhe përparësitë e ofruara në periudhën e të jetuarit, me dëshirën e madhe të tyre për dinjitet të grupit që i takon, ata lanë gjurmë në periudhën e jetës së tyre dhe fituan epitetin e personalitetit. Njeri prej tyre që la gjurmë në jetën e tij për të zgjuar vetëdijen kombëtare është padyshim Nazmi Arifi nga Ohri i Maqedonisë.

Në prag të 24 Qershorit "Ditës së Egjiptianëve të Ballkanit", është e nevojshme që të dimë më shumë për këtë personalitet për shkak se 24 Qershori është "vepër" e Nazmi Arifit. Personaliteti i Nazmi Arifit i nxori në dritë dëshirën dhe vullnetin e tij për dinjitet të popullit të tij. Ai ishte i prirë nga e drejta e popullit për të deklaruar përkatësinë e tyre etnike që ishte mohu në regjistrimet e popullsisë. Nazmi Arifi arriti që me 24 Qershor 1990 të themeloj Shoqatën e Egjiptianëve në shtetin e Jugosllavisë, atëherë kur vetëm sa u lejua krijimi i asociacioneve dhe organizatave politike, por që nuk ishin veprime aspak të pa rrezikshme nga regjimi i asaj kohe. Nga rrënjët e 24 Qershorit kanë buruar të gjitha lëvizjet dhe organizatat e popullit tonë në Ballkan, e që pas vitit 1999 në Kosovë me dy identitete: egjiptian dhe ashkali.

Në prag të 24 Qershorit po e sjellim një biografi të shkurtër të personalitetit të popullit tonë Nazmi Arifi.

Nazmi Arifi është lindur në Strugë, Maqedoni, me 17.02.1939. E ka mbaruar shkollën e mesme elektromakiniste në Shkup me 1961. Ka qenë aktiv në punën e shumë organizatave shoqëro-politike, anëtar i Kryesisë së Unionit të vëzhguesve (skauteve) të Maqedonisë dhe RSF të Jugosllavisë; anëtar i Kryesisë së Maqedonisë dhe të Jugosllavisë. Në vitin 1982 është shpërblyer me medalje për Merita të Popullit, nga Kryesia e RSF të Jugosllavisë.

Është themelues dhe kryetari i parë i Shoqatës së Egjiptianëve të Jugosllavisë në vitin 1990.



Kuvendi i Ohrit, 24 Qershor 1990, Ohër, Maqedoni



Ymer Komina, Usni Zemoski, Nazmi Arifi, Reshat Abazi dhe Baki Osmani, Ohër, 24 Qershor 1990



Me 20 nëntor 1990 , Nazmi Arifit i ndodhi aksident i rëndë dhe mbetet invalid në gjendje të rëndë. Ne vitin 1996 është recensor i librit të parë shkencor për Egjiptianët e Ballkanit “Përmbledhja e punimeve për etnogjenezën e Egjiptianëve në Maqedoni”. Me datën 27.09.1998 është proklamuar si anëtar nderi i Unionit Ballkano- Egjiptian.

Vdiq në Ohër me 05.11.2006.



Të dhëna gojore për hashkalitë në regjionin Llap-Gallapit

Xhemail Mustafa

E kam lexuar me vëmendje "KOMENTIN HISTORIK" te z. Marcel Cortiades, mirëpo do të jap disa të dhëna- gojore për hashkalitë në regjionin Llap-Gallapit (Podujevë-Prishtinë).

1. Në fillim dua te ceku se origjinaliteti i termit / emërtimit, i shqiptuar dhe i shkruar nuk është "ASHKALI" mirëpo HASHKALI. Pas luftës së fundit në Kosovë, PDAK-ja, sipas platformës se tyre e kanë bërë me qëllim ndryshim e termit / emërtimit, me arsyetimin se ASHKANLINJET janë të ardhur nga Persia, veçanërisht nga një dinasti që përafërsisht lidhet pak a shumë me termin e cekur me lart. Shoqata Shqiptaro-Egjiptiane, me vonë e transformuar në parti politike IRDK mbron termin Egjiptian në bazë të të dhënave historike të dr. Rubin Zemon. Te dy partitë politike të formuara pas luftës, ngritën zërin në institucionet Kosovare për të drejtat themelore të komunitetit tonë. OSBE (ndërkombëtare), Institucionet kosovare (vendast) dhe disa persona të zgjedhur rom, egjiptian, ashkali formuan një bashkësi RAE me qëllim që të arrijnë një qëndrueshmëri në politikë, ekonomi, gjendje sociale dhe arsimore. Zyra e kryeministrit dhe OSBE-ja përpiloj një dokument-Strategjia për integrimin e komunitetit RAE-2009-20015 me qëllim të mirë në integrimin në shtetin e Republikës së Kosovës. Mirëpo, në këtë bashkësi RAE janë disa konflikte-kundërthënie rreth çështjes së origjinës. Në medime publike - TV, gazeta, tubime shkencore, romet deklarojnë se egjiptianet dhe ashkalit jemi NJE "jemi të një brumi", Egjiptianet deklarojnë NE jemi me përkatësi etnike të veçantë.

2. Hashkalit e Llapit/ Gallapit, më se 80% janë Muhaxhir të Toplices, për shkak të luftës Serbo-Otomane të vitit 1878, Mbretëria Serbe me dhunë i përzuri me se 300 fshatra të banuar shqiptare, egjiptiane ku gjuhen, doket, zakonet i kishin të njëjta dhe të përbashkëta me shqiptaret, ndërsa me romët skishin asgjë të përbashkët. E tani ashkalit thonë: NA nuk jemi egjiptian, do të ndroja titullin e Marcel siç, ashtu siç preferojnë ashkalit "JU THONI EGJIPTIAN UNE JU MERJA ASHKALI" etj etj. Turq-rom, qerkez (hashkalit nuk përmenden në libra-shqip!) . Mirëpo, romet që jetojnë në llap e gollak nuk deklarojnë se na jemi Muhaxhir të Toplices, andaj konstatoj që ciganet e Toplices nuk janë shpërngulur në Kosovë. Vendasit, hashkalit e Kosovës, i kanë prite dhe janë kujdesur për Muhaxhirët -hashkali, Katundar shqiptarë të Kosovës thonin "NA ERDHEN MAGJUP". Hashkalit e Toplices erdhën se pari në Podujevë-Lupqë, Orllan, Barilevë, Trude, Milloshevë, Bashkij dhe disa fshatra deri në Prishtinë. Një serb-intelektual, rreth viteve 1902-12 në librin e tij përshkruan disa familje të banuar, siç e quan ai "CIGANI-Hashkali". Muhaxhirët Hashkali shpresonin se do të kthehen në vendet e tyre, ata jetonin neper fusha, ara, ndertonin "koliba" do të thot kasolle të ndërtuara me dru dhe lloq. Beglleret shqiptar ishin shumë të interesuar për fuqi punëtore (rrogëtar) dhe i pranuan të punojnë neper arat e tyre. Turqit, ngadalë u kthyen në shtetin e tyre bashkë me ta ikën edhe pashallarë -shqiptare me disa njerëz hashkali për në Izmir. Begleri-shqiptar i njohur SHERIF TRUDA, i cili ishte bashkëpunëtor i fashizmit Gjerman, fuqimisht ka intervenuar tek autoritetet fashiste që mos ti pushkatojnë ciganet, me arsyetim që nuk ka kush me të punoj tokat, fushat e Kosovës.


3. Është e vërtetë, sidomos në rrafshin e Kosovës, se bashkësia apo me mirë të themi komuniteti ynë është quajtur here pas here me emërtime të ndryshme, mirëpo shumica shqiptare na kanë quajtur MAGJUP (Shqiptaret, kuptimin i këtij termi e konsideronin të njëjtë me cigan). Në Perandorinë Otomane, popullata jonë identifikohet me emrin JERLI-romet na quanin ARLI-QIBANO (arli-shqiptar). Neper oda (dhoma të veçanta për mysafir) kur ishte një jabanxhi (i huaj), biseda ishte e rrjedhshme me një kujdes të veçantë të mos gabojnë dhe ta ofendojnë jabanxhiun (shqiptarin) kur nuk kishte të huaj në odë deklaroheshin, jemi të gjithë ESNAF. Po, ky term përdoret edhe në raste konflikti në mes veti, mos u ngatërroni mes veti se ne jemi esnaf (kuptimi i nocionit esnaf në shkencë ekonomike është bashkim zeje/artizanate). Nuk kemi të dhëna të shkruara për të kuptuar mirë domethënien e termave, sikur shqiptaret që identifikohen me "SHQIPONJAT". Shumica e çdo familje të mëdha të komunitetit tonë në Llap-Gollak identifikohen me emra speciale të trashëguar nga stërgjyshërit si p.sh Bellan, Batall, Bubar, Kollar, Moret, Tatar e shumë e shumë tjerë.

4. Pas luftës së dytë botërore, sistemi socialist-komunist i Jugosllavisë në krye me marshallin Tito, bëri një ndryshim rrënjësor në reformat ekonomike, ku rrogëtaria u zhduk, industria u zhvilluar, qytete të mëdha po ashtu kryeqyteti i Kosovës Prishtina kishin nevoja të madhe për fuqi punëtore. Shumë pjesëtarë tanë që jetonin nëpër fshatra ngadalë u vendosen në Prishtinë dhe Podujevë ku edhe formuan lagje (mahalla) të përziera: Hashkali, rom, serbski-cigani. Në fillim punuan si sharaqi, viteve 60 u punësuan nëpër fabrika, nëpër institucionet e atëhershme të Prishtinës, thuaj se të gjithë hashkalitë ishin korier-pastrues. Pak a shumë gjendja ekonomike ishte e përmirësuar, jetonin në kushte të mira jetese në krahasim me të kaluarën. Romet ishin në një numër me të madh në lagje të mëdha, dhe në çdo regjistrim i popullsisë deklaroheshin Rom. Popullata jonë ishte në dilemë se si të deklarohen, duke marrë parasysh se gjuha jonë ishte shqipe, deklarohen në regjistrime si shqiptar, musliman ose jugosllav. Te paktën disa persona të komunitetit tonë u arsimuan -shkrim e lexim por në gjuhën serbe, e me përhapjen e shkollave shqipe, u arsimuan në gjuhën shqipe. Dy vëllezër të ndjerë Y..., B... të komunitetit tonë, pas luftës së dytë botërore arritën të bëhen Mjek, B... ishte mjek-kapiten në ushtri, në Beograd. Ishte i martuar me një serbe, tani fëmijët e tij janë asimiluar në serb. Y... jetoi dhe punoj në spitalin e Shkupit, ishte i martuar me një maqedone, fëmijët e tij janë asimiluar në Maqedon. I ndjeri R... ishte një nëpunës i lart për mirëqenie sociale në Prishtinë. I ndjeri R... me profesion jurist, ishte referent i dhënies së certifikatave, përkthyes i gjuhës shqipe-serbe në Prishtinë. A... ishte mësues, me vonë drejtor i shkollës fillore, H... ishte referent i lartë i sigurisë së Kosovës dhe Jugosllavisë, ishte koleg i ngushtë i të ndjerit politikanit të njohur Mahmut Bakallit, i cili në mënyrë të fuqishme ka ra në konflikt me qarqet politike serbe. I ndjeri Mahmuti në një intervistë në TV-i faleminderoi pjesëtarët e komunitetit tonë, që e kanë shpëtuar nga rreziqet. Shkollimi-arsimimi ishte i madh për komunitetin tonë pas viteve 1974-1990, thua çdo familje ishte me kualifikime të mesme shkollore. Nen sundimin e Millosheviqit, konflikti i njohur politik mes serbeve-shqiptarëve, fëmijët e komuniteti tonë e ndërprejnë shkollimin fillor ku edhe ndikoi në uljen e arsimimit.

5. Kultura, Muzika, Sporti të komuniteti ynë thua ishte në një nivel të ulët. As një pjesëtar yni nuk ishte artist teatral, filmi, ose i interesuar të shkojnë në teatër, po ashtu nuk kemi ndonjë që është marrë me letërsi-poezi (pas viteve 1990, veprimtarët egjiptian janë marrë pak me poezi). Muzika, sidomos ajo popullore ka qenë e pranishme, romët janë të njohur si instrumentist-vallëzues, ishin anëtarë muzikor të ansamblit "Shota" dhe radio Prishtinës. Te popullata jonë ishte i pranishëm instrumenti "Qymbyshi", muzikantët rom dhe hashkali ishin të shoqëruar bashkë. Sporti, sidomos klubi i boksit në Prishtinë, gjithnjë ishte i pari në ish jugosllavi duke i faleminderuar bokseve të shumtë hashkali. Po i përmendi vetëm dy boksier me karrierë të gjatë, Buzolli me medalje Bronzit (Vendin e dytë në boks botëror) Rexhepi (Evropian).

6. Në vitet 90-ta, me rënien e komunizmit dhe përhapjen e demokracisë, e drejta e mendimit të lirë dhe shprehjes, disa veprimtar të komunitetit tonë në Prishtinë, Fushë Kosovë filluan të merren me informimin e popullatës tonë në gjithë Kosovën, të diskutohet, analizojmë, të vendosim dhe të marrim iniciativën për çështjen e deklarimit dhe formimin e shoqatës EGJIPTIANE në Kosovë, edhe unë isha në këtë iniciativë. Popullata jonë ishte në dilemë, politika serbe krijonte dhunë ndaj shqiptarëve, u zhduk partia komuniste, krijohen parti politike të shumta, dy parti ishin të mëdha-SPS e Millosheviqit dhe LDK-e Rugovës. U krijua te popullata jonë një mosbesim në qeveritaret Serb dhe shqiptarët e Kosovës. Veprimtarët tanë, në të gjitha tubimet kishin nevojë të sqarojmë gjere e gjate, formimi i shoqatës tonë nuk ishte politike e as që merreshim me politikën e shtetit, nuk ishim të detyruar të bashkangjitemi asnjë partie, qëllimi primar i shoqatës do të jetë çështja e identitetit dhe origjinës, deklarimi i lire i popullatës, të kemi rubrikën tonë në regjistrimin e popullsisë që kishte një rendësi të madhe. Me anën e ligjit dhe kushtetutës do të na garantohen të drejtën në pjesëmarrje në të gjitha institucionet e shtetit si dhe punësim, arsim, social i kemi të garantuara etj. Çështja e termit hashkali është diskutuar edhe në atë kohë ku ka pas mendime të ndryshme, termi hashkali për rrafshin e dukagjinit ka qenë i pa njohur. Vertetë, veprimtarët e iniciativës së formimit të shoqatës kanë pasur një punë e përgjegjësi të madhe deri të shpallja oficiele e shoqatës Egjiptiane të Kosovës me datën 21.10.1990 në Prishtinë.

7. I shpreh ngushëllime familjeve të komunitetit tonë që kanë humbur me të dashurit e tyre. Lufta solli shumë të këqija për gjithë popullatën e Kosovës dhe Serbisë. Lirisht mundem të them se asgjë nuk është bërë për zbardhjen e vrasësve, rrahjes, ndjekjen, uzurpimeve të pronave të komunitetit tonë. Institucionet përkatëse të Kosovës po ashtu dhe te EULEX-it deri me tani nuk kanë dhënë rezultate të mjaftueshme, as dy partitë politike dhe OJQ -ja (RAE) nuk janë aktiv në ngritjen e zërit për çështjen e të zhdukurve!. Me trazirat e Marsi të vitit 2004, te komuniteti ynë u krijua një mosbesim në marrëdhëniet shoqërore në mes shqiptarëve, ku është një thënie "ski çka i bon gomarit mshoj samarit", shqiptarët nuk patën mundësi të sulmojnë serbet, i vërsulen hashkalinjet... Popullata jonë është një popullatë e urtë, nuk janë agresiv, respektojnë ligjet e shtetit, rrallë ose hiq nuk janë në burgjet Kosovare dhe Evropiane. Emigrantët tanë në diasporë e kalojnë një jetë të lumtur, punojnë, arsimohen me dëshirë që të integrohen në shoqërinë e atyre shteteve, atdhetarët të komuniteti tonë nuk kanë vullnet të kthehen në Kosovën e varfër.



Botohet libri “Antropologjia Socio-Kulturore e Egjiptianëve në Ballkan” e autorit Dr. Rubin Zemon

Me 24 Qershor 2013, në Ditën e Egjiptianëve të Ballkanit, në Bibliotekën Universitare në Prishtinë, është promovuar libri “Antropologjia Socio-Kulturore e Egjiptianëve të Ballkanit”, e autorit Dr. Rubin Zemon. Ky libër nga autori, por edhe nga referuesit në ditën e promovimit, është vlerësuar si studimi i parë shkencor ku vendosen bazat e qartësimit të grupit të veçantë etnik i cili jeton në vendet e Ballkanit dhe me gjerë. Ky libër është botuar nga Shoqata e Shkrimtareve të Pejës, është recensuar nga Dr. Veselin Popov, Dr. Elena Marushiakova, Dr. Milena Benovska Sebkova, Dr. Mirella Decheva Stefanova, Dr. Miodrag Kalendar Hadzi Ristiaë. Redaktor përgjegjës i librit është Esat Loshaj nga Shoqata e Shkrimtarëve të Pejës, lukturimi, dizajnimi i ballinës dhe radhitja kompjuterike është bërë nga Fazli Stollaj.

Parathënia e librit është shkruar nga Fazli Stollaj, ku është bërë një përshkrimi i shkurtër i përmbajtjes së librit. Libri përmban Hyrjen ku janë përfshirë Qëllimet dhe detyrat e hulumtimit, Terminologjia dhe metodat e hulumtimit, Burimet dhe literatura dhe Përfshirja kronologjike dhe areale e hulumtimit. Në pjesën tjetër është bërë analizë e përgjithshme e Egjiptianëve të Ballkanit ku në veçanti janë shpjeguar Etnonimet dhe Toponimet e Egjiptianëve të Ballkanit. Tituj tjerë të këtij libri janë Shpërndarja gjeografike e Egjiptianëve të Ballkanit, Identiteti etnik dhe mimikria etnike e Egjiptianëve të Ballkanit. Në pjesën tjetër të librit të titulluar “Të dhënat historike, arkeologjike për ardhjen dhe prezencë të Egjiptianëve të Ballkanit” janë përfshirë periudha e Lashtë, periudha Romake, periudha Bizantine, periudha Osmane, periudha e paraqitjes së Nacionalizmit në Ballkan dhe periudha e Lëvizjes së Egjiptianëve në Ballkan. Në libër është trajtuar edhe Gjuha, Kultura materiale ku janë trajtuar Profesione, Bujqësia dhe Profesione tjera të Egjiptianëve të Ballkanit. Në kulturën materiale janë përfshirë edhe Lagjet, Shtëpitë dhe Interieri shtëpiak, Stolitë dhe Veshjet. Kultura shoqërore në këtë libër përfshinë Familjen Inokose dhe Familja e Zgjeruar. Kultura shpirtërore përfshinë Dituritë popullore, Medicinën popullore, Krijimtaria popullore gojore, Vallet popullore dhe Besimet Popullore dhe përkatësia konfesionale e Egjiptianëve të Ballkanit. Në libër janë trajtuar edhe Doket Popullore gjatë lindjes dhe martesës, Doket gjatë synetit dhe Doket gjatë ceremonive mortore. Gjithashtu janë trajtuar doket drejtësore dhe doket e lidhura me punën. Pjesa përfundimtare e librit përmban konkluzionet në gjuhën shqipe dhe angleze dhe fototeka që përmban fotografi nga periudha dhe treva të ndryshme që përshkruajnë identitetin e Egjiptianëve të Ballkanit.

Diskutimet nga Tryeza “ Pozita Juridike dhe Politike e Egjiptianëve në Ballkan”



Elbert Krasniqi - Faleminderit që iu keni përgjigjur pozitivisht ftesës sonë në këtë tryezë diskutimi, faleminderit secilin prej juve për zemërsisht për pjesëmarrje që me aktin shumë simbolik por që dëshmon që për rreth kësaj kauze përpos një uni të caktuar të njerëzve që kanë pozita në shoqërinë civile e disa pozita politike, e ju si aktivist dhe pjesëtar të komunitetit egjiptian jeni të interesuar që pozita e jonë sociale, politike, juridike të përforcohet përmes këtyre diskutimeve. Para se të fillojmë të bisedojmë për temën unë kisha faleminderuar mysafiret tonë të veçantë të cilët vijnë nga Struga të cilët kanë pranuar një sfidë shumë të veçantë dhe shumë të rrallë, janë nisur për në Pejë prej Strugës pa e njohur asnjërin prej neve. Ata e kishin kuptuar se do të bisedojmë për pozitën e

Egjiptianëve dhe ata shumë thjeshtë, me shkëmbim të disa emailëve dhe mesazheve kanë pranuar një sfidë që të takojnë njerëz të rinjë të cilët i takojnë të njëjtës kauzë.


Tema e sotme e diskutimit është Pozita politiko juridike e Egjiptianëve në Ballkan ku ka qenë e paraparë që të diskutoj Rubin Zemon e cili në pa mundësi që të marrë pjesë do të lidhet vija skype, Behar Sadiku nga Shqipëria i cili mungon, Beslim Hoti i cili as ai nuk ka ardhur. Pra sot do të diskutojmë për pozitën e egjiptianëve në Kosovë dhe Maqedoni për gjendjen faktike të tyre. Për shkak se kanë kaluar vite që nga viti 1990 kur ka filluar aktiviteti, pastaj në Kosovë kemi pozitë juridike që dallon nga vendet tjera, ka vend të diskutimit lidhur me pozitën tonë.



Xhevdet Neziraj - Unë po e marrë të drejtën që të diskutoj në periudhën prej themelimit të shoqatës, e për më tepër për aktivitetin e IRDK-së, si subjekt politik i cili që nga themelimi ka qenë gardian i mbrojtjes së komunitetit Egjiptian në Kosovë, dhe ku e ka sjell pozitën e komunitetit Egjiptian në pozitë shumë të mirë kushtetuese. Pra komuniteti Egjiptian në Kosovë është komunitet i pranuar me kushtetutën e Kosovës, sikurse komunitetet tjera që jetojnë në Kosovë. Pra komuniteti Egjiptian në Kosovë është i përcaktuar edhe nga Ligji për Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve ku në mënyrë taksative thuhet se komunitetet tradicionalisht që jetojnë në Kosovë janë serbët, turqit, romët, goranët, egjiptianët etj. Arsyeja pse them se IRDK ka qenë gardian i komunitetit egjiptian

është fakti se jemi organizuar menjëherë pas luftës atëherë kur pozita e komunitetit ka qenë mjaftë e rendë, pra në fillim kemi qenë në mbrojtje fizike të qenies së komunitetit dhe deri diku ia kemi arritur që të ulën tensionet që u ngritën ndaj komunitetit, pra arritëm që së bashku me subjektet shqiptare të vazhdojmë një jetë ashtu si e kemi pas më parë. IRDK është pjesë e të gjitha legjistaturave në Kosovë dhe jemi pjesë e hartimit të Kushtetutës së Kosovës dhe Deklaratës së pavarësisë së Kosovës, pra komuniteti egjiptian është pjesë e shtet ndërtimit të Kosovës. Prandaj ne në Kosovë jemi shumë më përpara se vendet tjera në rajon, pra politikisht dhe juridikisht në Kosovë jemi para Egjiptianëve të Shqipërisë, para Egjiptianëve të Maqedonisë dhe Malit të Zi. Si subjekt politik kemi marrë pjesë në të gjitha zgjedhjet që janë organizuar në Kosovë, ku në mandatin e parë kemi qenë me dy deputet dhe në dy mandatet tjera me nga një deputet. Ndoshta pozita e jonë nuk është ajo që duhet me qenë, ndoshta kemi pritë më shumë por unë jam shumë

zemër gjerë me i dëgjuar hallet dhe problemet por edhe kritikën sepse ka lider që nuk kanë dëshirë me u këshilluar se duhet të veprosh kështu ose ashtu, Unë i takoj një prej atyre liderëve që i pranojnë edhe kritikën sepse kritikën e juaja më shijnë për të punuar më shumë për të menduar më shumë, por në anën tjetër jam shumë rigiroz me ata njerëz që i kanë bërë dëm IRDK-së ku me ose pa vetëdije i kanë shkaktuar dëm komunitetit ne si IRDK do ti kundërshtojmë kushdo qofshin ata, thelles apo baballar të kombeve, ne nuk do të humbim një dekadë të tërë nuk do ta gjuajmë në ujë një punë të pa lodhshme të shokëve por edhe timin personal por edhe të popullatës sepse popullata është shumë e qartë ku është orientuar nga ne ku ne të fillojmë dhe të punojmë për ata. Unë mendoj se pozita e komunitetit nuk është siç kemi menduar dhe siç presim por nuk është edhe aq e keqe. unë këtu nuk jam në ndonjë fushatë por sikur të isha unë do të kisha prezantuar shumë të mira dhe të këqijat mos me i përmend. Unë jam shumë i vullnetshëm që e i lënë hapësirë edhe të tjerëve atë se çka IRDK ka pasur mundësi me ba e nuk e ka ba, për shkak se ato rekomandime mua do të më shërbejnë për të ardhmen. Ndoshta ju nuk e dini se ne kemi ndërmarrë veprime por nuk kemi mundur me i realizuar, për shkak se ka punë që mund të kryhen dhe që nuk mund të kryhen, mirëpo është mirë me dëgjuar këtu konkretisht ato që ka mundur IRDK me i ba e nuk i ka ba. Unë ju uroj ditën Kombëtare të gjithë egjiptianëve e që e kemi caktuar 24 Qershorin, që e kemi arritur me një konsensus të plotë me të gjitha subjektet që kanë vepruar. Unë kisha mundësi me caktuar një datë që i takonte IRDK-së, timin personal ose kolegëve të mijë por kemi shkuar në formën që kjo datë të na bashkon, në këtë datë secili egjiptian të ndihet mirë me ditën e tyre dhe jo të IRDK-së, ndonjë shoqatë ose ndonjë subjekti. Çështja e formalizimit të kësaj date tash ka kaluar në Qeverinë e Kosovës dhe me siguri të madhe kjo datë do të formalizohet edhe në Parlamentin e Kosovës.



Argjend Zuko - Të nderuar vëllezër, në emër të egjiptianëve në Strugë, Maqedoni, kam kënaqësinë të përshëndes këtë tubim me shpresë se do të kontribuojmë në perspektivat për një status më të mirë në të vendet ku jeton pakica e egjiptianëve në Ballkan. Egjiptianët e Kosovës duhet të ndjehen krenar sepse në institucionet e larta politike janë të përfaqësuar me deputet, që për fat të keq ne pjesëtarët e pakicës egjiptiane në Maqedoni nuk e gëzojmë këtë. Arsyeja për situatën e tillë sipas mendimit tim është aktiviteti shumë i dobët i shoqatave dhe organizatave që e përfaqësojnë këtë komunitet. Aktivitetet e drejtuara vetëm për realizim të interesave personale të një pakice që i udhëheqin këto shoqata. Gjeneza ose burimi i identifikimit si egjiptianë lindi në Strugë, dhe duke iu faleminderuar aktivitetëve të gjeneratës më të vjetër

ky identifikim u përhap dhe u realizua në të gjitha trojet e Ballkanit. Duke e marrë parasysh Shqipërinë dhe Kosovën, popullata në Strugë, për momentin, është e pa organizuar sepse pjesa më e madhe janë shkolluar dhe gëzojnë autoritete të jashtëzakonshme nga bashkë atdhetarët. Egjiptianët në Strugë karakterizohen si popull i urtë dhe i ndershëm, popull besimtar që i respekton dhe nderon traditat, në përgjithësi, fetare dhe nacionale të Egjiptianëve. Një pjesë e vogël gjendet në studime nga lëmia islamo juridike, nga lëmia e medicinës, ekonomike etj. Deri në vitin 200 selia e partisë së Egjiptianëve të Maqedonisë ishte në Strugë pra Partia për Lëvizje të Egjiptianëve në Maqedoni. Pjesëtarët e kësaj partie në vitin 1997 ishin në vizitë në Egjipt dhe për herë të parë në Qeverinë e Egjiptit është biseduar për statusin e Egjiptianëve në Maqedoni e më gjerë. Nga shuarja e partisë politike, pjesërisht funksionon Shoqata e Egjiptianëve në Maqedoni dhe Unioni Ballkanik i Egjiptianëve. Udhëheqësit e Shoqatave të përmendura në Strugë dhe Ohër nuk kanë përkrahje masovike për arsye se aktivitetet e këtyre shoqatave nuk janë transparente dhe në suazat e tyre nuk kanë anëtarësi të re. Për fat të keq u tolerua ndërhyrja e kauzës rome, të cilës për aktivitetet e tyre shumicës së egjiptianëve i asimiluan në romë duke iu ofruar oferta të volitshme sociale e shoqërore nga fondacione të ndryshme ndërkombëtare për zhvillimin dhe perspektivën e romëve në Maqedoni. Për momentin në Strugë përsëri paraqiten aktivist patriot për stopimin e agjendës rome, ndoshta të ndihmuar nga përfaqësuesit e të ashtu quajturve udhëheqës të egjiptianëve. Qëllimi është ndoshta perspektiva që e nesërmja të jetë më e mirë. Përfaqësia në Strugë dhe më gjerë jemi të interesuar për ofrimin e shoqatës që të realizojmë amanetin e të parëve tanë, ku përmes shoqatës të përfitojmë fondacione të financuara nga fondacionet e jashtme për të drejtat e njerëzve. Udhëheqës i aktivitetit tonë do të jetë teza e filozofit të shquar Rene Dekard: "Mendoj për atë, për atë arsye jetoj".



Dr. Skender Marolli - Ju uroj 24 Qershorin dhe jam i lumtur që tani për herë të parë po e festojmë 24 Qershorin. Është një ditë me nismë të mbarë, ose së paku paralajmëron diçka të tillë që të shihet një dritë në fund të tunelit. Në veçanti përshëndes vëllezërit nga Struga dhe kjo është një shenjë e mirë që ky komunitet do të ofrohet njeri me tjetrin. Sa i përket pozitës politike tek ne në Kosovë, edhe pse jemi në disa forma të organizuara, ne jemi në pozitë të pa volitshme karshi të tjerëve në Kosovë. Shumë pak kemi njerëz në pozita dhe mund të numërohen në gishta, ndërsa pjesa e Dukagjinit qëndron më mirë në çdo pikëpamje në krahasim me Rrafshin e Kosovës. Pra pozita jonë politike nuk qëndron shumë keq për shkak se kemi parti politike të cilat janë të përfaqësuar në instancën më të lartë, në Parlamentin e Kosovës. Ne

kishim abicie që kemi me u përfaqësuar me tre deputet në Parlamentin e Kosovës por kjo nuk ndodhi. Unë i shoh dy çështje shumë të vështira për komunitetin. E para, Varfëria, që është e pa diskutueshme që ekonomikisht nuk qëndrojmë si duhet, pra kemi raste kur kafshatën e gojës njerëzit e sigurojnë prej kontinierëve. Unë jam shumë i emocionuar kur i shoh këto raste sepse në radhë të parë janë qenie njerëzore dhe kuptohet se të shumtë në këtë gjendje janë edhe romët. E dyta Arsimimi, nuk qëndrojmë aspak mirë me arsimim. Në anën tjetër, në Kosovë ndasitë janë evidente: ashkali dhe egjiptian dhe ne konsiderojmë se jemi një entitet. Kush e shpiku këtë REA dhe si duhet të çrrënjësojmë, e së fundi është diskutuar edhe në Parlament. Nëse mendohet se këta njerëz janë në gjendje ekonomike shumë të vështirë, dhe duhet të qesim lot krokodili për këta njerëz me një ngjyrë të përafërt. Unë mendoj se distanca në mes të romëve në njërin anë dhe egjiptianëve dhe ashkalive në anën tjetër nuk duhet të diskutohet. Nëse do të ishim bashkë egjiptianët dhe ashkalitë atëherë numerikisht, jo numri i të arsimuarve, do të ishim komuniteti i dytë, menjëherë pas shqiptarëve në Kosovë.



Imer Alijaj - Unë do të jem shumë i shkurtër, i përgëzoj këta djemtë nga Struga që në një far mënyre unë po e shoh se do ta ngjallin popullatën egjiptiane në Maqedoni. Duket se ka shumë pak aktivitete ka në Maqedoni që zëri i Egjiptianëve të dëgjohet në Parlamentin e Maqedonisë, në popullatën shqiptare dhe maqedone dhe ju do të jeni ata që do të prini popullit dhe nëse është nevoja edhe me ndihmën tonë. Ndoshta jemi ardhur në një situatë sikur shqiptarët që interesohen për Preshevë, edhe ne të interesohemi edhe për Maqedoni dhe vende tjera. Edhe ne kemi pas probleme në fillim, nuk kemi menduar se do të shkojmë në Parlament por kemi dalë që ta mbrojmë popullatën në luftë pastaj në paqe dhe tani ta ngrisim popullatën tonë qoftë ekonomikisht qoftë në forma tjera.



Bajram Shkodrani - Çështjen e viteve 90 e kemi prit me skepticizëm dhe çështja kryesore është se ne jemi popull i veçantë nga romët dhe këtu duhet të punojmë shumë. Për librin që po botohet ka lëvdata të shumta ku me këtë libër qartësohet mirë se çfarë populli jemi. Deri më tani na kanë përzier shumë dhe mund të them se ne e kemi një njeri shumë të madh që e ka shkruar këtë libër dhe ky autor i këtij libri duhet të përkrahet nga diaspora në mënyrë që hulumtimi të vazhdojë më tutje.



Adem Abazaj - Të gjithë ne po flasim se duhet bashkëpunim më i madh, duhet opinion më i madh etj. Kam dëgjuar se RTK 2 është hapur dhe ishte dashur që në mënyrë institucionale të përqendrohemi që të marrim sa më shumë hapësirë, ose aq sa na takon edhe neve dhe përmes mediave, sidomos elektronike, opinionet tona do të fuqizohen edhe bashkëpunimi do të ishte më i mirë duke zhvilluar debate, takime pasi që këtë të drejtë e ka çdo komunitet dhe pse mos të shfrytëzojmë atë të drejtë. Sigurisht se ne kemi njerëz profesionist që mund të bëjnë këtë punë prandaj ne nuk duhet të humbim këtë shans.



Muharrem Asllani - Ju përgëzoj për këtë ditë madhështore dhe kjo do të jetë dita më e rëndësishme që do të shkruaj historia në të ardhmen. Është një ditë që njerëzit që nuk janë këtu prezent, kanë dëshiruar shumë që të shijojnë këtë ditë. Për fat të mirë amanetin e tyre do ta qojmë në vend edhe duhet të fokusohemi në atë drejtim që të mos pretendojmë pozita individuale por pozita e komunitetit të jetë prioriteti ynë. Mburremi që sot jemi të përfaqësuar deri në instanca më të larta institucionale, për fat të keq Maqedonia këtë të drejtë nuk e ka. Pozita e egjiptianëve në Maqedoni nuk është e mirë dhe unë në vitet e 90 si 18 vjeçar kur isha sekretar i degës së shoqatës në Fushë Kosovë, e kisha pranuar me tërë vullnetin sepse ishte realizuar ëndrra se çka jam unë. Unë me tërë qenien time e

pranova identitetin egjiptian e cila thirrje erdhi prej Maqedonisë. Në vitet e 70 në Maqedoni ka pasur lëvizje për regjistrim si egjiptian e në republikat tjera nuk ka qenë kështu. Pra ku ishte Maqedonia atëherë e ku është sot. Këtu nuk është faji te Maqedonia por është faji te komuniteti i cili duhet të organizohet dhe të luftoj për vetveten. Për këtë nuk vjen as Komisioni Evropian e as Këshilli i Evropës. Bile Këshilli i Evropës jep me miliona për asimilimin edhe të ashkalive edhe egjiptianëve në romë. Po të mos ishte shoqata e parë e Egjiptianëve në Maqedoni e pastaj Shoqata e Egjiptianëve të Kosovës gjatë viteve 90 ne sot nuk do të organizoheshim. Gjatë viteve 90 në organizimin e egjiptianëve në Kosovë nuk kishte ashkali. Termi ashkali ishte vetëm term lokal që kishte kaluar nëpër disa trajta po rras luftës njerëz për përfitime personale dhe duke shërbyer si mashë e tjetër kujt na shfaqen edhe këtë identitetin e ri nese mund të quajmë identitet. Ne egjiptianët dhe ashkalitë jemi një komunitet, nuk dallojmë me asgjë, ndërsa me komunitetin romë dallojmë në mënyrë drastike. Ne me bashkëpunim me njeri tjetrin mund të fuqizohemi duke mos i pasur në rend të parë interesat personale. Ne jemi pjesë e kushtetutës dhe ligjeve por ne nuk jemi pjesë reale e jetës sepse jemi pjesë vetëm në letër. Në këtë rast dua ti drejtohem fillimisht vetvetes dhe të gjithë të rinjë të gjeneratës sime me këto fjalë: Ne e kemi një vradë, jo shtrat lumi, ku në atë vradë nganjëherë kalon uji e nganjëherë është e thatë. Këtë vradë e kemi para vetes por atë duhet të shndërrojmë në shtrat lumi. Ne duhet të kontribuojmë në fushën që mendojmë se jemi të mirë e jo në një fushë që në vend se të ndihmojmë mund të dëmtojmë procesin.



Veton Berisha, - Kjo është hera e parë që festojmë dhe mund të ketë edhe vërejtje për mënyrën e organizimit. Vetë fakti se në ditën e Egjiptianëve IRDK e ka mbështet promovimin e librit të Dr. Rubin Zemon tregon se ne kemi raporte shumë të mira me autorin. Ne Dr. Rubin Zemon e vlerësojmë si profesionist dhe raporti i jonë ma atë është në këtë cilësi si profesionist. Ne e vlerësojmë së me datën 24 Qershor ku po e bëjmë promovimin e librit, ky është një sadisfaksion për ne, ku ky libër është arma më e mirë të cilën do të shfrytëzojmë në të ardhmen. Çështje tjetër është se nuk kontestohet se a jemi egjiptian. Ne jemi shumë tolerant edhe me institucione edhe me komunitete tjera, ku për shkak të tolerancës tonë njerëz te caktuar e kanë manipuluar identitetin tonë. Tani e tutje, në aspektin e

identitetit mos të jemi tolerant, ta mbrojmë me andje dhe me nostalgji identitetin tonë. Ne kemi pasur mundësi që ditën tonë të përcaktojmë qysh në vitin 2008 por kemi menduar që të ofrohemi me komunitetin ashkali por kemi vërejt se kjo nuk shkon prandaj kemi bërë shumë mirë që e kemi caktuar ditën e egjiptianëve. Prandaj ky libër është një armë e mirë që në përvjetorin tjetër shpresojmë që të kemi edhe tjera botime. Kështu fuqizohet identiteti dhe komuniteti ynë.



"Porta e Luani" ose "Akeri" në Mikeni, Peloponcz, Greqi



Familje Egjiptiane nga Istogu, Kosovë, 1969



Familje Egjiptiane nga Struga, Maqedoni, 1974



Pjestar nga komuniteti Egjiptian nga qyteti Madan, Bullgari, 2004



Grupi muzikor i priër nga Sami Qorri, Gjakovë, 1973



Gazmend familjar në Gjakovë, 1971



Grupi muzikor i priër nga Sami Qorri, Aslan Luboja, Gjakovë, 1973



Qamili i Vogël, Hadi Bajrami, Qazim Berisha, Ismet Peja dhe grupi, Gjakovë, 1968



Grupi muzikor me Hadi Bajramin, Gjakovë, 1968



Grupi muzikor me Hadi Bajramin, Gjakovë, 1968



Hadi Bajrami dhe grupi i tij muzikor, Gjakovë, 1966



Hadi Bajrami dhe grupi i tij muzikor, Gjakovë, 1968



Kuvendi i Ohrit, 24 Qershor 1990



Nazmi Arifi në Kuvendin e Ohrit, 24 Qershor 1990



Ymer Komina, Usni Zemoski, Nazmi Arifi, Reshat Abazi dhe Baki Osmani, Ohër, 24 Qershor 1990



Kuvendi i Ohrit, 24 Qershor 1990



Akademik Zija Shkodra në Simpoziumin për bashkëjetesë etnike në Shqipëri, 1999



Akademik Ramadan Sokoli në Simpoziumin për bashkëjetesë etnike në Shqipëri, 1999



Presidenti i Kosovës Dr. Ibrahim Rugova në takim me Ibish Bajramin, Imer Alijaj dhe Xhevdet Neziraj, Prishtinë, 2000



Beslim Hoti, Sali Berisha kryeministër i Republikës së Shqipërisë, 2006



Nënshkrimi i Deklaratës së Pavarësisë nga ana e deputetit Xhevdet Neziraj, Kosovë, 2008



Fazli Stollaj, Dr. Martin Bernal, Dr. Rubin Zemon dhe Xhevdet Neziraj, Shkup, 2009



Tubimi i Egjiptianëve të rajonit dhe diasporës për parçaktimin e 24 Qershorit Ditës së Egjiptianëve, Pejë, 2012



Xhevdet Neziraj në pritje të delegacionit të lartë nga Egjipti, Prishtinë, 2012



Statuja e zotreshes Zdrada në Ohër, Maqedoni



Familje Egjiptiane nga Istogu, Kosovë, 1966



Familja dhe grupi Majovci, nga Dibra, Maqedoni



Familje Egjiptiane nga Korça, Shqipëri, 1985

Familje Egjiptiane nga Dukagjini, Kosovë, 1976